REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 7 maj 2026
Nr.: ref.: AGJ3047/26

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI275/25

Parashtrues

Blerim Kopreshi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës në lëndën [CN. nr. 77/20] në Gjykatën Themelore në Prizren

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Nexhmi Rexhepi, kryetar
Safet Hoxha, zëvendëskryetar
Bajram Ljatifi, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Blerim Kopreshi, me vendbanim në Komunën e Prizrenit (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson Teki Bokshi, avokat nga Gjakova.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e kohëzgjatjes së procedurave përkitazi me gjykimin e lëndës me numër [C. nr. 77/20] të Gjykatës Themelore në Prizren (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës gjyqësore përkitazi me gjykimin e lëndës [C. nr. 77/20] në Gjykatën Themelore. Në lidhje me këtë të fundit, parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të neneve 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës Nr. 01/2003 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 1 shtator 2025, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën e tij përmes postës, të cilën Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) e pranoi më 5 shtator 2025.

6. Më 6 tetor 2025, Kryetari i Gjykatës përmes Vendimit [nr. GJR. KI275/25] caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci gjyqtare raportuese, ndërsa përmes Vendimit [nr. KSH. KI275/25] caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Safet Hoxha (kryesues), Radomir Laban dhe Jeton Bytyqi (anëtarë).

7. Më 20 tetor 2025, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe të njëjtit i kërkoi që në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh të dorëzojë (i) formularin e plotësuar të kërkesës; dhe (ii) vendimin e kontestuar së bashku me vendimet tjera relevante apo dokumentet e nevojshme që kanë të bëjnë me këtë kërkesë.

8. Më 28 tetor 2025, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës dorëzoi formularin së bashku me dokumentet e kërkuara.

9. Më 12 janar 2026, Gjykata njoftoi Gjykatën Themelore për regjistrimin e kërkesës dhe i kërkoi informata shtesë përktiazi me statusin e lëndës [C.nr. 77/20] dhe veprimeve të ndërmarra.

10. Më 12 shkurt 2026, Gjykata Themelore dorëzoi në Gjykatë informata përkitazi me lëndën civile [C.nr.77/20].

11. Më 23 prill 2026, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës. Në të njëjtën ditë, Gjykata në përbërje të plotë vendosi: (I) të shpallë kërkesën të pranueshme; (II) të konstatojë se ka pasur shkelje të paragrafit 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E Drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, përkitazi me të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm kohor.

Përmbledhja e fakteve

12. Rrethanat e rastit konkret ndëlidhen me procedurën e shpronësimit të paluajtshmërisë "*P-71813068-05286-1 ZK,Prizren*" (në tekstin e mëtejmë: prona kontestuese), e cila ndodhet në zonën kadastrale Prizren, në sipërfaqe prej 1069,52 m2, nga ana e Kuvendit Komunal të Prizrenit (në tekstin e mëtejmë: Kuvendi Komunal), e cila evidentohej në emër të paraardhëses së parashtruesit të kërkesës E.K. në cilësi të bashkëpronares, përmes kontratës së dhurimit [Leg. nr. 7041/2009] të 8 shtatorit 2009.

13. Më 17 korrik 2008, Kuvendi Komunal përmes Aktvendimit [nr. 01/011-3736] aprovoi Planin rregullues urbanistik, në të cilin ishte planifikuar projekti "Dardania -2, Prizren", përmes së cilës prona kontestuese është shpallur zonë me interes publik.

14. Më 14 tetor 2010, Kuvendi Komunal përmes Vendimit përfundimtar [nr. 03/3-463-/P] shpronësoi pronën kontestuese.

15. Më 12 shkurt 2014, paraardhësja e parashtruesit të kërkesës, ndër të tjera, parashtroi ankesë në Kuvendin Komunal, kundër Aktvendimit [nr. 01/011-3736] të 17 korrikut 2008, të Kuvendit Komunal si dhe Vendimit përfundimtar për shpronësim [nr. 03/3-463-/P] të 14 tetorit 2010, me pretendimin se ndër të tjera, vendimet në fjalë i drejtohen subjektit të vdekur, përkatësisht babait të paraardhëses së parashtruesit të kërkesës H.B., i cili vërtetohej se kishte ndërruar jetë më 27 gusht 2001, dhe se procesi trashëgimor ishte shqyrtuar nga Gjykata Komunale në Prizren përmes Aktvendimit [T. nr. 94/09] të 22 majit 2009, dhe, për rrjedhojë, vendimet në fjalë nuk u janë dorëzuar trashëgimtarëve ligjorë me kohë, përkatësisht të njejtat i kishin pranuar më 24 janar 2014, sikurse nuk ishin publikuar në Gazetën Zyrtare, duke i pamundësuar të njëjtave parashtrimin e ankesës me kohë.

16. Më 18 mars 2014, Kuvendi Komunal u përgjigj në ankesën e paraardhëses së parashtruesit të kërkesës, duke theksuar se *"[...] ne si drejtori kemi zbatuar vendimin përfundimtar për shpronësim Nr. 03/3-463-/P të datës 14 tetor 2010, dhe vendimim për miratimin e planit rregullues urban nr. 01/011-3736, të datës 17.07.2014, me të cilën palët kanë pasur të drejtën e ankesës brenda 30 dite, i cili vendim është shpallur në gazetën "Kosova Sot*".

17. Më 8 prill 2014, paraardhësja e parashtruesit të kërkesës, ndër të tjera, dorëzoi kërkesëpadi dhe kërkesë për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë në Gjykatën Themelore në Prizren kundër Kuvendit Komunal, duke kërkuar: (i) anulimin e Aktvendimit 01/011-3736 për Miratimin e Planit Rregullues Urban dhe Vendimin përfundimtar të shpronësimit; (ii) ndërprerjen e procedurës së shpronësimit në tërësi; (iii) ndryshimin e Vendimit preliminar dhe fushëveprimin e procedurës së shpronësimit duke përjashtuar pronat lëndore dhe të drejtat e caktuara dhe të konstatohet se shpronësimi i atyre pronave është në kundërshtim në paragrafin 1 të nenit 4 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e pronës së paluajtshme (në tekstin e mëtejmë: Ligji për shpronësimin); si dhe (iv) caktimin e masës së përkohshme

e sigurisë, duke i ndaluar Komunës së Prizrenit që ta tjetërsojë, ngarkojë, disponojë apo të zhvillojë çfarëdo punimesh ndërtimore në ngastrën kadastrale 5286/1 dhe 5286/2 në vendin e quajtur "Keqishllak" në sipërfaqe prej 1069,52 m2 nga sipërfaqja e tërësishme prej 7590 m2.

18. Më 11 janar 2015, nëna e parashtruesit të kërkesës ndërroi jetë.

19. Më 7 maj 2019, parashtruesi i kërkesës, ndër të tjerë, parashtroi parashtresë me të cilën kërkoi precizimin e kërkespadisë së 8 prillit 2014 në kuptimin e subjektivitetit, duke pasur parasysh që paraardhësja e parashtruesit të kërkesës kishte ndërruar jetë më 11 janar 2015, me njoftimin se parashtruesi i kërkesës dhe dy anëtarët e ngushtë të familjes N.K. dhe N.L. paraqiten si propozues në vend të së ndjerës E.K.

20. Më 8 maj 2019, Gjykata Themelore mbajti seancë dëgjimore në të cilën përmes Aktvendimit [CN. nr. 603/16] aprovoi propozimin e parashtruesit të kërkesës për precizimin e kërkesëpadisë në kuptim të subjektivitetit të palëve në procedurë, ashtu që në cilësi të propozuesve pranoi parashtruesin e kërkesës dhe N. K. dhe N. L., si trashëgimtarë ligjorë, ndërkaq obligoi propozuesit që deri në seancën e radhës gjykatës t'ia prezantoj vendimet preliminare dhe atë përfundimtare të shpronësimit.

21. Më 23 korrik 2019, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [CN. nr. 603/16] u shpall jokompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur sipas kërkesëpadisë së parashtruesit të kërkesës dhe ia dërgoi të gjitha shkresat Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje administrative.

22. Më 30 dhjetor 2019, Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje adminsitrative përmes Aktvendimit [A. nr. 2309/2019] filloi konflikt të kompetencës duke mos e pranuar kompetencën lëndore për të vendosur në këtë çështje juridike, me pretendimin se kompetente për të vendosur në këtë çështje është Gjykata Themelore në Prizren, Departamenti Civil, për faktin se kemi të bëjmë me shpronësim të pronës komunale.

23. Më 6 shkurt 2020, Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit [AN. nr. 18/2020] vendosi Gjykatën Themelore në Prizren, si gjykatë kompetente për të trajtuar lëndën e parashtruesit të kërkesës, duke kërkuar që shkresat e lëndës t'i dërgohen për veprim të mëtejmë kësaj gjykate.

24. Në një datë të pacaktuar të vitit 2021, parashtruesi i kërkesës ndër të tjerë, dorëzoi parashtresë për caktimin e seancës përgatitore.

25. Më 10 qershor 2024, parashtruesi i kërkesës ndër të tjerë, parashtroi lutje për caktimin e gjykimit.

26. Më 1 shtator 2025, parashtruesi i kërkesës, ndër të tjerë, parashtroi urgjencë për caktimin e gjykimit;

27. Aktualisht lënda evidentohet me numër [CN.nr.77/20] dhe ndodhet në Gjykatën Themelore në Prizren.

28. Më 12 janar 2026, me qëllim të qartësimit të procedurave në lidhje me lëndën civile [CN. nr. 77/20], Gjykata i kërkoi Gjykatës Themelore informata përkitazi me statusin e lëndës, me ç'rast, kjo e fundit përmes përgjigjes së 12 shkurtit 2026, sqaroi se ka caktuar seancën gjyqësore e cila pritet të mbahet më 23 mars 2026.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

29. Parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes aktgjykimit të kontestuar, i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojta e Pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

I. Lidhur me pretendimin për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës lidhur me nenin 6 të KEDNJ-së

30. Parashtruesi i kërkesës thekson se *"zvarritja e procedurës gjyqësore për më shumë se 10 vite (nga viti 2014 deri më sot, 2025) përbën shkelje të të drejtës për gjykim të drejtë dhe brenda një afati të arsyeshëm […]"*.

31. Parashtruesi i kërkesës i referohet jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për të vlerësuar nëse një proces është zhvilluar brenda një afati të arsyeshëm, duke theksuar se duhet të merren parasysh katër elemente: (i) kompleksiteti i rastit; (ii) sjellja e autoriteteve gjyqësore; (iii) sjellja e palëve; dhe (iv) rëndësia e çështjes për parashtruesin e kërkesës.

32. Në kontekst të pretendimit të mësipërm, parashtruesi i kërkesës pretendon se lënda është e thjeshtë në natyrë, vonesat kanë ardhur nga mosveprimi i gjykatave të rregullta dhe transferimi i pajustifikuar i kompetencës ndërmjet Gjykatës Themelore në Prizren me Gjykatën Themelore në Prishtinë, kalimi i më shumë se 10 viteve pa asnjë vendim meritor është i pajustifikueshëm sipas çdo standardi juridik, çështja ka rëndësi thelbësore për parashtruesin, sepse lidhet me pronën e tij, burim i të ardhurave dhe sigurie ekonomike.

33. Parashtruesi i kërkesës tutje thekson se, pas kthimit të lëndës në Gjykatën Themelore në Prizren, janë mbajtur disa seanca gjyqësore, por nuk është marrë asnjë vendim përfundimtar dhe nuk është caktuar masë e përkohshme për mbrojtjen e pronës dhe nuk ka ansjë arsyetim ligjor për vonesën *"shumëvjeçare"*.

34. Parashtruesi i kërkesës pretendon se qytetarët kanë të drejtë që çështjet e tyre të zgjidhen me vendim gjyqësor brenda një periudhe të arsyeshme, në mënyrë që drejtësia të mos *bëhet "e vonuar"*, sepse *"drejtësia e vonuar është drejtësi e mohuar"*.

35. Parashtruesi i kërkesës thekson se në praktikën e saj, Gjykata ka konstatuar disa herë shkelje të nenit 31 të Kushtetutës për vonesa të gjata procedurale. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës i referohet rasteve të Gjykatës, ku kjo e fundit ka konstatuar shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, respektivisht rasteve KI97/11, KI06/17 dhe 34/19.

II. Lidhur me pretendimin për shkelje të Nenit 46 të Kushtetutës

36. Parashtruesi i kërkesës thekson se ka qenë pronar i ligjshëm i pronës që është objekt i procedurës së shpronësimit nga Komuna e Prizrenit. Tutje parashtruesi i kërkesës

pretendon se pavarësisht se shpronësimi është iniciuar në vitin 2014, deri më sot (i) nuk është dhënë kompensim i drejtë dhe i menjëhershëm; (ii) nuk është marrë vendim përfundimtar gjyqësor që përcakton të drejtën e pronësisë ose të kompensimit; dhe (iii) prona është lënë në pasiguri juridike, me mundësi dëmtimi ose humbjeje, pa mbrojtje ligjore efektive.

37. Parashtruesi i kërkesës tutje pretendon se mungesa e kompensimit për më shumë se një dekadë është cenim thelbësor i të drejtës në pronë, sepse parashtruesi është privuar nga prona pa kompensim dhe pa procedurë të rregullt ligjore.

Dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31
[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

"[...]
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
[...]"

Neni 46
[Mbrojtja e Pronës]

"1. E drejta e pronës është e garantuar.
2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.
3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëj ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohet.
4. Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.
5. Prona intelektuale mbrohet me ligj."

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6
(E drejta për një proces të rregullt)

"1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. [...]".

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

38. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

39. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> *[...]*
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

40. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

> Neni 47
> (Kërkesa individuale)
>
> *"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*
>
> *2. Individi mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*
>
> Neni 48
> (Saktësimi i kërkesës)
>
> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*
>
> Neni 49
> (Afatet)
>
> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]".*

41. Sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata duhet fillimisht të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar në kuptimin e paragrafit 7 të nenit 113 të Kushtetutës, për të parashtruar kërkesë para Gjykatës. Gjykata vëren se procedurat fillestare ishin iniciuar nga paraardhësja e parashtruesit të kërkesës E.K., e cila kishte

ndërruar jetë më 21 mars 2019. Lidhur me këtë, më 7 maj 2019, parashtruesi i kërkesës kishte dorëzuar në Gjykatën Themelore parashtresën përkitazi me precizimin e kërkespadisë së 8 prillit 2014 në kuptim të subjektivitetit të palës propozuese, duke e njoftuar të njëjtën se parashtruesi i kërkesës ndër të tjerë është shpallur trashëgimtar ligjor i të ndjerës, të cilin propozim e aprovoi Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [CN. nr. 603/16] të 8 majit 2019. Rrjedhimisht edhe parashtruesi i kërkesës nga ky moment fitoi legjitimitetin aktiv në çështjen kontestuese.

42. GJEDNJ-së ka përcaktuar se për të paraqitur kërkesë para Gjykatës një person duhet të jetë "*viktimë*" e shkeljes kushtetuese, "*direkte*" apo "*indirekte*". Në kontekst të viktimës indirekte ose të tërthortë, siç është konfirmuar në rastin KI211/25 [parashtrues *Burbuqe Pruthi*, Aktgjykim i 11 dhjetorit 2025], praktika e Gjykatës është posaçërisht e konsoliduar në rrethana të pretendimeve para Gjykatës lidhur me dështimin e shtetit për të përmbushur detyrimet pozitive për mbrojtjen e të drejtës në jetë sipas garancive të nenit 25 [E Drejta për Jetë] të Kushtetutës dhe nenit 2 (E drejta për jetën) të KEDNJ-së (shih, rastet e Gjykatës KI41/12, me parashtrues *Gëzim dhe Makfire Kastrati*, Aktgjykim i 26 shkurtit 2013, lidhur me paraqitjen e kërkesës nga prindërit e të bijës së ndjerë; dhe KI129/21, me parashtruese *Velerda Sopi*, Aktgjykim i 7 marsit 2023, lidhur me paraqitjen e kërkesës nga vajza e të ëmës së ndjerë). Ngjashëm, Gjykata ka vepruar edhe në kontekst të së drejtës për privatësinë dhe jetën familjare, të garantuar me nenin 36 [E Drejta e Privatësisë] të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të KEDNJ-së, duke marrë parasysh rrethanat e veçanta të rastit përkatës (shih, rastin KI56/18, me parashtrues *Ahmet Frangu*, Aktgjykim i 22 korrikut 2020, lidhur me paraqitjen e kërkesës nga prindi i të ndjerit). Së fundi, Gjykata ia ka njohur statusin e "*viktimës*" edhe parashtrueses së kërkesës në rastin KI211/25, e cila ishte në marrëdhënie bashkëshortore me paditësin tashmë të ndjerë, në procedurën kontestimore për shpronësimin e një prone. Parashtruesja e kërkesës në këtë rast kontestonte kohëzgjatjen e procedurës gjyqësore, me ç'rast pretendonte shkelje të së drejtës në gjykim të drejtë dhe në kohë të arsyeshme (shih rastin e Gjykatës, KI211/25, parashtruese *Burbuqe Pruthi,* cituar më lart, paragrafi 45).

43. Prandaj, në parim, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, statusi i viktimës indirekte ose të tërthortë, u është njohur vetëm familjarëve të ngushtë apo personave të afërm, të cilët kanë arritur të dëshmojnë se kanë interes legjitim lidhur me çështjen në fjalë (shih, rastin e Gjykatës KI211/25, parashtruese *Burbuqe Pruthi,* cituar më lart, paragrafi 45 dhe referencat e përdorura aty).

44. Gjykata ka sqaruar, rast pas rasti, që statusi i viktimës indirekte ose të tërthortë është po ashtu i ndërlidhur me natyrën e të drejtave që kontestohen para Gjykatës, përkatësisht nëse të drejtat përkatëse mund të cilësohen si të drejta të "*transferueshme*" apo jo. Për më tepër, Gjykata vëren se në ato raste kur statusi i viktimës iu ka akorduar të afërmve, duke i lejuar ata të parashtronin një kërkesë në lidhje me ankesat e tyre, përkatësisht, në kuadër të nenit 6 të KEDNJ-së, GJEDNJ mori parasysh faktin nëse parashtruesit mund të kishin interes material në bazë të efektit të drejtpërdrejtë në të drejtat e tyre monetare (shih, rastet e Gjykatës KI211/22 parashtrues: *IsmajI Ipshi, Bashkim Ipshi, Gjevdet Ipshi, Bekim Ipshi dhe Besim Ipshi,* Aktvendim për papranueshmëri, i 1 tetorit 2024, paragrafi 79; dhe rastet e GJEDNJ-së *Micallef kundër Maltës*, kërkesa nr. 17056/06, Aktgjykim i 15 tetorit 2009, paragrafi 48).

45. Në rastin konkret, pasi paraardhësja e parashtruesit të kërkesës, përkatësisht nëna e tij kishte ndërruar jetë, i njëjti kishte parashtruar parashtresë përkitazi me ndryshimin e

subjektivitetit të palës propozuese, e cila edhe i ishte aprovuar përmes Aktvendimit [CN. nr. 603/16] të 8 majit 2019 të Gjykatës Themelore. Rrjedhimisht, duke pasur parasysh rrethanat e rastit konkret, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës ka interes të drejtpërdrejtë përkitazi me pronën kontestuese dhe si pasojë është palë e autorizuar për të paraqitur kërkesë para Gjykatës, sipas paragrafit 7 të nenit 113 të Kushtetutës, nenit 47 të Ligjit dhe pikës 34 (1) (a) të Rregullores së punës.

46. Për më tepër, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës konteston kohëzgjatjen e procedurës lidhur me lëndën civile [CN. nr. 77/20], duke specifikuar se të njejtit i është shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së. Ai gjithashtu pretendon se mungesa e kompensimit për më shumë se një dekadë është cenim thelbësor i të drejtës në pronë, sepse parashtruesi është privuar nga prona pa kompensim dhe pa procedurë të rregullt ligjore, duke cenuar të drejtën e pronës, të garantuar me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës.

47. Në këtë drejtim, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës ka qartësuar të drejtat dhe liritë themelore që pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit.

48. Në kontekst të pretendimit për shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë dhe kohë të arsyeshme, të garantuar me paragrafin 2 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës konteston kohëzgjatjen e procedurës gjyqësore për anulimin e vendimit për shpronësim, e cila ende nuk ka përfunduar, pasi rasti është kthyer në kompetencë lëndore të Gjykatën Themelore dhe ende pret të vendoset nga kjo e fundit. Gjykata, duke marrë parasysh natyrën e pretendimeve, përkatësisht kohëzgjatjen e procedurës, rikujton se në rrethana të tilla nuk kërkohet përmbushja e kushteve të parashikuara me nenin 49 (Afatet) të Ligjit, përkatësisht kushti për paraqitjen e kërkesës brenda katër (4) muajve, pasi lënda është ende në zhvillim e sipër.

49. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara në rregullin 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. Paragrafi (2) i rregullit 34 të Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Në këtë drejtim, paragrafi 2 i rregullit 34 të Rregullores së punës specifikon:

> *(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".*

50. Gjykata thekson se kërkesa përmbush kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në paragrafin 1 të rregullit 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës dhe se e njëjta nuk mund të shpallet e papranueshme, bazuar në kushtet e përcaktuara nga paragrafi 2 i rregullit 34 të Rregullores së punës. Përveç kësaj dhe përfundimisht, Gjykata thekson se kërkesa nuk mund të deklarohet e papranueshme në asnjë bazë tjetër, prandaj, ajo duhet të deklarohet e pranueshme dhe të vlerësohen meritat e saj.

Meritat e kërkesës

51. Gjykata fillimisht rikujton se rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me kërkesën për anulimin e aktvendimit përkitazi me shpalljen e pronës kontestuese zonë me interes të përgjithshëm dhe vendimit përfundimtar të shpronësimit të pronës kontestuese nga ana e Kuvendit Komunal të Prizrenit, në procedurë administrative. Siç rezulton nga dosja e lëndës, fillimisht paraardhësja e parashtruesit të kërkesës nga prilli i vitit 2014 kishte iniciuar kërkesëpadi dhe kërkesë për caktimin e masës së sigurisë në Gjykatën Komunale në Prizren kundër Organit të Shpronësimit të Kuvendit Komunal me kërkesën për anulim të vendimeve të shpronësimit dhe ndërprerjen e procedurës së shpronësimit në tërësi. Në ndërkohë, paraardhësja e parashtruesit të kërkesës kishte ndërruar jetë, me ç'rast parashtruesi i kërkesës e kishte njoftuar Gjykatën Themelore për paraqitjen e propozuesve të rinj si trashëgimtar të saj. Gjykata Themelore mbajti seancë dëgjimore, me ç'rast aprovoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës ndër të tjerë, për precizimin e kërkesëpadisë dhe ndryshimit të propozuesit në kuptimin subjektiv. Më 23 korrik 2019, Gjykata Themelore u shpall jokompetente në pikëpamje lëndore dhe lëndën ia dërgoi Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamentit për çështje administrative, për të cilën kjo e fundit inicioi konfliktin e kompetencës në Gjykatë të Apelit, duke e refuzuar të njëjtën. Më 6 shkurt 2020, Gjykata e Apelit shpalli Gjykatën Themelore në Prizren kompetente në pikëpamje lëndore dhe rasti iu kthye sërish për shqyrtim. Parashtruesi i kërkesës kishte dorëzuar disa urgjenca për caktimin e seancës dhe përshpejtim të procedurës, në vitin 2021, më 10 qershor 2024 dhe më 1 shtator 2025. Aktualisht, lënda e parashtruesit të kërkesës evidentohet me numër [CN. nr. 77/20] dhe ndodhet në Gjykatën Themelore në Prizren e cila sipas informatave të pranuara më 12 shkurt 2026 nga kjo gjykatë, rezulton që seanca e radhës ishte caktuar të mbahet më 23 mars 2026.

52. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës pretendon se, si rezultat i kohëzgjatjes së paarsyeshme të procedurës gjyqësore sipas kërkesëpadisë që ende nuk ka marrë zgjidhje përfundimtare nga gjykatat e rregullta, i është shkelur e drejta e tij për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

53. Gjykata në vazhdim do të trajtojë pretendimin e parashtruesit të kërkesës për kohëzgjatjen e procedurave në lëndën [CN. nr. 77/20] në bazë të parimeve të përgjithshme të përcaktuara përmes praktikës së saj gjyqësore, por edhe asaj të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

I. Vlerësimi i Gjykatës

Parimet e përgjithshme përkitazi me të drejtën për "gjykim brenda një afati të arsyeshëm"

54. Gjykata rikujton se paragrafi 2 i nenit 31 të Kushtetutës përcakton se: *"Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme [...]".*

55. Ndërsa, paragrafi 1 i nenit 6 të KEDNJ-së përcakton se: "*Çdo person ka të drejtë që [...] të dëgjohet [...] brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë [...], e cila do të vendosë [...] në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij [...] civile [...]".*

56. Prandaj, bazuar në dispozitat e lartcekura, e drejta për një vendim brenda një afati të arsyeshëm është pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

57. Lidhur me këtë, Gjykata tashmë ka një praktikë relativisht të konsoliduar gjyqësore që përfshin por nuk kufizohet në rastet: (i) KI64/23, parashtruese *Mejrem Qehaja Rexha,* Aktgjykim i 31 gushtit 2023; (ii) KI06/21, parashtrues *Dragan Mihajlović,* Aktgjykim i 22 dhjetorit 2022; (iii) KI19/21, parashtrues *Sadik Pllana,* Aktgjykim i 18 korrikut 2022; (iii) KI142/23, parashtrues *Fadil Berisha,* Aktgjykim i 12 shkurtit 2025. Në praktikën e saj gjyqësore, Gjykata ka afirmuar parimet e vendosura nga GJENDJ-ja, duke përfshirë rastet: (i) *Poiss kundër Austrisë*, nr. 9816/82, Aktgjykim i 23 prillit 1987; (ii) *Abdoella kundër Holandës*, nr. 12728/87, Aktgjykim i 25 nëntorit 1992; (iii) *Comingersoll S.A. kundër Portugalisë*, nr. 35382/97, Aktgjykim i 6 prillit 2000; (iv) *Scordino kundër Italisë* (nr.1), nr. 36813, Aktgjykim i 29 marsit 2006; (v) *Frydlender kundër Francës*, nr. 30979/96, Aktgjykim i 27 qershorit 2000; (vi) *Sürmeli kundër Gjermanisë*, nr. 75529/01, Aktgjykim i 8 qershorit 2006; (vii) *Famullia Katolike Greke Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë*, nr. 76943/11, Aktgjykim i 29 nëntorit 2006; dhe (viii) *Nicolae Virgiliu Tănase kundër Rumanisë*, nr. 41720/13, Aktgjykim i 25 qershorit 2019.

58. Bazuar në praktikën e lartcekur gjyqësore, rezulton se: (i) përllogaritja e kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore fillon nga momenti kur gjykata kompetente vihet në lëvizje me kërkesë të palës për vendosjen e një të drejte apo interesi legjitim të pretenduar; (ii) gjatë llogaritjes merret për bazë procedura në tërësinë e saj, përfshirë këtu edhe procedurat e apelimit dhe procedurën e ekzekutimit të një vendimi gjyqësor përfundimtar; (iii) arsyeshmëria e zgjatjes së një procesi gjyqësor duhet të vlerësohet duke u bazuar në rrethanat përkatëse dhe veçoritë e secilit rast; dhe se (iv) shteti është i detyruar që të organizojë sistemin e drejtësisë në mënyrë të tillë që gjykatat të mund të garantojnë të drejtat e secilit për një vendim përfundimtar gjyqësor, në lidhje me të drejtat dhe obligimet civile të tyre brenda një afati të arsyeshëm kohor (shih, rastet e GJEDNJ-së: *Poiss kundër Austrisë*, cituar më lart, paragrafi 50; *Comingersoll kundër Portugalisë,* cituar më lart, paragrafi 24; dhe *Famullia Katolike Greke Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 142; dhe rastet e Gjykatës KI06/21, cituar më lart, paragrafët 50-75; dhe KI19/21, cituar më lart, paragrafi 82; dhe KI142/23, cituar më lart, paragrafi 47).

59. Për më tepër, sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe asaj të GJEDNJ-së, arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës gjyqësore matet duke u bazuar në këto kritere kryesore: (i) kompleksiteti i rastit, (ii) sjellja e palës, (iii) sjellja e autoriteteve shtetërore, dhe (iv) rëndësia e asaj se çfarë është në rrezik për palën në kontestin gjyqësor (shih, rastin e GJEDNJ-së: *Surmeli kundër Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafi 128; si dhe rastet e Gjykatës KI64/23, cituar më lart, paragrafi 65 dhe KI142/23, cituar më lart, paragrafi 48).

60. Përkitazi me (i) kompleksitetin e rastit, kjo mund të ndërlidhet me çështjet faktike dhe ligjore; me përfshirjen e disa palëve në procedurë; me një numër të caktuar provash që duhet trajtuar para gjykatave të rregullta; apo edhe me një numër më të madh të raporteve të ekspertëve që kërkohen. (shih, në mënyrë të ngjashme rastin e Gjykatës: KI64/23, cituar më lart, paragrafët 66-67; KI142/23, cituar më lart, paragrafi 49; dhe rastet e GJEDNJ-së: *Papachelas kundër Greqisë*, nr. 31423/96, Aktgjykim i 25 marsit 1999; dhe *Nicolae Virgiliu Tanase kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 210).Thënë këtë, edhe në rastet kur një procedurë nuk është komplekse, mungesa e qartësisë dhe parashikueshmërisë në legjislacionin vendor mund të vështirësojë zgjidhjen e rastit dhe të kontribuojë në kohëzgjatjen e procedurës (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Famullia Katolike Greke Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 150).

61. Përkitazi me (ii) sjelljen e palës në procedurë, nuk kërkohet nga pala bashkëpunim aktiv me autoritetet gjyqësore, e as nuk mund të fajësohet pala për përdorimin e mjeteve juridike sipas legjislacionit në fuqi, megjithatë, autoritetet shtetërore nuk mund të mbahen përgjegjëse nëse këto veprime ndikojnë në kohëzgjatjen e procedurës; nga pala kërkohet vetëm të jetë e vëmendshme në ndërmarrjen e hapave proceduralë dhe të mos përdorë taktika për ta shtyrë procedurën në favor të tij; dhe se vetëm vonesat që i atribuohen Shtetit mund të ndikojnë në përcaktimin nëse procedurat nuk kishin përfunduar brenda një afati të arsyeshëm kohor. Disa shembuj që kanë të bëjnë me sjelljen e palës janë: mungesa e vullnetit për të dorëzuar shkresat, e cila mund të ndikojë në ngadalësimin e procedurës; ndryshimi i shpeshtë i avokatit; përpjekjet për të arritur marrëveshje jashtëgjyqësore; nisja e procedurës përpara gjykatës që nuk ka juridiksion për çështjen; mungesa e kujdesit në ndërmarrjen e hapave proceduralë (shih, rastet e GJEDNJ-së: *Erkner dhe Hofauer kundër Austrisë*, cituar më lart, paragrafi 68; dhe *Union AlemntariaSanders S.A kundër Spanjës*, nr. 11681/85, Aktgjykim i 7 korrikut 1989, paragrafi 35). Sjellja e palës përbën një fakt objektiv që nuk mund t'u atribuohet autoriteteve shtetërore dhe duhet të merret parasysh gjatë vlerësimit nëse procedura ishte kryer brenda një periudhe të arsyeshme kohore (shih, rastin e Gjykatës: KI64/23, cituar më lart, paragrafi 68-70; dhe KI142/23, cituar më lart, paragrafi 50).

62. Sa i përket (iii) sjelljes së autoriteteve kompetente, shteti mban përgjegjësi për të gjitha autoritetet, dhe jo vetëm për sistemin gjyqësor, por edhe për sjelljet e institucioneve publike; gjatë vlerësimit nëse procedura është kryer brenda një afati të arsyeshëm kohor, gjykata duhet ta vlerësojë procedurën në tërësi; përkundër që shteti mund të jetë përgjegjës për defekte të caktuara procedurale, megjithatë, kjo nuk e përjashton mundësinë që të ketë vepruar në përputhje me detyrat e veta për ta shqyrtuar rastin në mënyrë të shpejtë; shkaktimi i vonesave nga ndërrimi i shpeshtë i gjyqtarëve nuk e shmang përgjegjësinë e shtetit për kryerjen e procedurave brenda afateve të arsyeshme kohore; mbingarkesa kronike e lëndëve nuk mund të shërbejë si arsyetim për stërzgjatjen e procedurave; dhe se gjykatat nuk mund të lejojnë që rasti të bartet pafundësisht prej një instance gjyqësore te tjetra (shih, rastet KI64/23, cituar më lart, paragrafët 71-73; dhe KI142/23, cituar më lart, paragrafi 51).

63. Sa i përket (iv) rëndësisë së asaj se çfarë është në rrezik për palën në kontest, ekzistojnë kategori të caktuara të rasteve të cilat, për nga natyra e tyre, duhet të trajtohen me kujdes të veçantë dhe të vendosen me shpejtësi më të madhe. Shembuj të këtyre kategorive të rasteve përfshijnë: rastet që ndërlidhen me statusin; rastet që ndërlidhen me kujdestarinë e fëmijëve; me raportin prind-fëmijë; me kujdesin e gjyshërve ndaj fëmijëve, kur këta të fundit kanë mbetur pa kujdesin e prindërve; përgjegjësinë e prindërve dhe të drejtat e kontaktit me fëmijët; rastet që ndërlidhen me kontestet nga marrëdhënia e punës; ankesa kundër largimit nga puna; suspendimi nga puna; transferimi; rikthimi në punë; rastet që ndërlidhen me persona të cilët vuajnë nga "*sëmundje të pashërueshme"* dhe kanë *"pritje të reduktuar të jetëgjatësisë*"; rastet që lidhen me pretendimet për ushtrim të dhunës nga zyrtarët policorë; dhe rastet kur mund të rrezikohet e drejta e edukimit. Disa raste të tjera nuk kërkojnë vëmendje të shtuar, p.sh. rastet që lidhen me kompensimin e dëmit të shkaktuar në aksidente rrugore, apo rastet që kanë të bëjnë me ndarjen e trashëgimisë ndërmjet trashëgimtarëve të personit të vdekur (shih, rastet e Gjykatës: KI64/23, cituar më lart, paragrafi 74; dhe KI142/23, cituar më lart, paragrafi 52).

Aplikimi i parimeve të lartcekura në rrethanat e rastit konkret

Periudha që do të merret parasysh

64. Gjykata rikujton se rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me kërkesën për anulim të procedurës së shpronësimit të paluajtshmërisë së kontestuar, e cila ishte iniciuar nga paraardhësja e parashtruesit të kërkesës, ndër të tjerë, nga ana e Kuvendit Komunal të Prizrenit. Gjykata vëren se në lidhje me rastin, ishte zhvilluar procedura administrative dhe ajo gjyqësore. Ndërsa sa i përket procedurës gjyqësore, Gjykata vëren se kërkesa në procedurë jokontestimore ishte filluar në vitin 2014, ndërsa, nga informatat e paraqitura Gjykata vëren se në vitin 2019 ishte bërë ndryshimi në kuptim të subjektivitetit të palëve në procedurë. Gjykata Themelore përmes aktvendimit ishte shpallur jo-kompetente në pikëpamje lëndore, ndërkaq Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm Administrativ kishte filluar konfliktin e kompetencave. Gjykata e Apelit caktoi Gjykatën Themelore në Prizren me kompetencë lëndore dhe territoriale për të shqyrtuar lëndën në fjalë. Bazuar në informatat e pranuara nga Gjykata Themelore më 12 shkurt 2026, rasti është ende në shqyrtim në Gjykatën Themelore.

65. Në këto rrethana të rastit, Gjykata vlerëson se rasti gjyqësor i parashtruesit të kërkesës, përkitazi me çështjen që është objekt i shqyrtimit para Gjykatës, sipas informatave të dorëzuara, ka filluar në vitin 2014, ndërsa parashtruesi i kërkesës është paraqitur si propozues dhe trashëgimtar i paraardhëses që në vitin 2019. Rasti në fjalë ka vazhduar të shqyrtohet deri më 12 shkurt 2026, datë kjo kur Gjykata ka pranuar informata nga Gjykata Themelore. Kjo periudhën përfshinë kohëzgjatjen prej më tepër se njëmbëdhjetë (11) vite, dhe e njëjta ende pret të zgjidhet nga Gjykata Themelore, prandaj kjo është periudha që do të merret parasysh nga Gjykata.

66. Për të arritur një përfundim se a është zgjidhur rasti i parashtruesit të kërkesës brenda një afati të arsyeshëm, Gjykata më tej do të vlerësojë (i) ndërlikueshmërinë e rastit, (ii) sjelljen e palës, (iii) sjelljen e organeve shtetërore, si dhe (iv) rëndësinë e asaj që është në rrezik për palën në kontestin gjyqësor.

(i) Përkitazi me kompleksitetin e rastit

67. Për sa i përket ndërlikueshmërisë së çështjes, Gjykata bazuar në shkresat e lëndës vëren se në rastin konkret ka pasur dy procedura të ndryshme, ajo administrative dhe procedura gjyqësore, si dhe mungesë të dokumentacionit të kontestuar, të cilat do të kenë ndikuar sadopak në ndërlikueshmërinë e rastit. Gjykata gjithashtu vëren se Gjykata Themelore mbajti një seancë dëgjimore në të cilën aprovoi precizimin e padisë dhe ndryshimin të propozuesve në kuptim të subjektivitetit, dhe më pas shpalli jokompetencën lëndore, e cila pas procedurës së konfliktit të kompetencës, iu kthye sërsh në kompetencë të saj lëndore dhe territoriale.

68. Pavarësisht rrethanave të lartcekura, Gjykata vlerëson se kompleksiteti i lëndës nuk mund të justifikoj mosvendosjen e rastit për një periudhë kaq të gjatë kohore. Për më tepër, Gjykata vëren se që nga kthimi i kompetencës lëndore më 6 shkurt 2020, Gjykata Themelore vetëm në vitin 2026 ka caktuar të mbajë seancën gjyqësore dhe atë për 23 mars 2026.

(ii) Përkitazi me sjelljen e palës

69. Lidhur me sjelljen e palëve, Gjykata vëren që fillimisht paraardhësja e parashtruesit të kërkesës, ndër të tjerë, dhe më pas edhe nga parashtruesi i kërkesës, ndër të tjerë, kishin ndërmarrë veprimet procedurale që u ishin kërkuar nga autoritetet relevante dhe gjykata kompetente për zgjidhjen e lëndës së tyre në kohë të arsyeshme. Nga 8 prilli 2014, me kërkesë të palëve ishte vënë në lëvizje Gjykata Themelore, dhe në harkun kohor prej më shumë se njëmbëdhjetë (11) vitesh, palët kishin ndërmarrë më tepër se pesë (5) veprime procedurale për realizimin e të drejtës së tyre, në rrugë ligjore jokontestimore. Në këtë kontekst, Gjykata, duke pasur parasysh veprimet e ndërmarra nga palët paditëse, vlerëson se palët në procedurë nuk i kanë kontribuar vonesave, rrjedhimisht nuk kishin përdorur mënyra për të zvarritur procedurën.

(iii) Sjellja e autoriteteve kompetente

70. Gjykata, në vlerësimin e sjelljes së autoriteteve kompetente, thekson se që nga aktivizimi i gjykatës së shkallës së parë, përkatësisht nga viti 2014, gjykatat respektive kanë ndërmarrë mbi katër (4) veprime procedurale, përkatësisht (1) një seancë dëgjimore, por pa ndonjë vendim përfundimtar për palët, (2) shpallje të jokomptenecës lëndore; (3) kthim të kompetencës lëndore; dhe (4) ftesën për seancë gjyqësore. Për më tepër, Gjykata pas informatave të siguruara nga Gjykata Themelore në Prizren, përkitazi me lëndën e parashtruesit të kërkesës ka kuptuar se kjo çështje është ende në pritje të mbajtjes së seancës shqyrtuese nga kjo e fundit.

71. Duke pasur parasysh të lartcekurat, si dhe veprimet procedurale të ndërmarra nga Gjykata Themelore, Gjykata thekson se përgjegjësia për zvarritjen e lëndës në këtë rast nuk mund t'i atribuohet sjelljes së parashtruesit të kërkesës por autoriteteve publike, duke pasur parasysh faktin se ndër të tjera kishte edhe kërkesë për caktimin e masës së sigurisë dhe se procedura e shpronësimit konsiderohet si çështje të natyrës urgjente, vonesa të cilat, ndër të tjera, dëmtojnë besimin e publikut në organet publike dhe posaçërisht ato të drejtësisë.

(iv) Rëndësia e asaj çfarë është në rrezik për parashtruesin në kontest

72. Në lidhje me parimin e rëndësisë së asaj se çfarë është në rrezik për palën në kontest, Gjykata rikujton se sipas praktikës së konsoliduar të GJEDNJ-së, disa kategori të rasteve kërkojnë vëmendje të veçantë dhe urgjencë në veprimtarinë e gjykatave të brendshme, duke pasur parasysh ndikimin e drejtpërdrejtë që mund të ketë rezultati i procedurës mbi të drejtat themelore të palës. Në këtë kontekst, rasti i parashtruesit të kërkesës ka të bëjë me kërkesën për anulimin e vendimeve për shpallje të pronës kontestuese zonë me interes të përgjithshëm si dhe anulim të vendimit për shpronësim, rrjedhimisht nuk bën pjesë në kategori siç janë kontestet familjare, marrëdhëniet e punës apo çështjet statusore. Megjithatë, bazuar edhe në ligjin për shpronësim, por veçanërisht duke marrë për bazë faktin që sipas nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, përkatësisht paragrafin 3 të këtij neni që përcakton se "*Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëj eksproprijimin e pronës nëse [...] pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave eksproprijohet",* kjo procedurë duhet të trajtohet me prioritet. Kjo pasi, ndër të tjera, Gjykata vëren se neni 46 i Kushtetutës në raste të ekspropriimit vë theksin në "*kompensimin e menjëhershëm*", andaj si e tillë edhe duhet të trajtohet me prioritet.

73. Prandaj, marrë për bazë të gjitha kriteret e lartcekura, Gjykata thekson se rasti i parashtruesit të kërkesës vazhdon të jetë në shqyrtim në gjykatën e shkallës së parë, që do të thotë se e drejta e parashtruesit për zgjidhje përfundimtare dhe në kohë të rastit të tij mbetet e parealizuar.

74. Gjykata konsideron se tejzgjatja e trajtimit të çështjes në fjalë, është e papranueshme në rrethanat e rastit konkret dhe si e tillë është në kundërshtim të plotë me të drejtën e parashtruesit të kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm, ashtu siç garantohet nga paragrafi 2 i nenit 31 të Kushtetutës dhe paragrafi 1 i nenit 6 të KEDNJ-së (shih, *mutatis mutandis,* rastin e Gjykatës, KI120/25, parashtrues *Mustafa Shefkiu,* cituar më lart, paragrafi 54).

Përfundim në lidhje me pretendimin për shkeljen e paragrafit 2 të nenit 31 të Kushtetutës

75. Nga sa më sipër, marrë parasysh parimet e lartcekura të vendosura përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të aplikuara në rrethanat e rastit konkret, Gjykata konsideron se kohëzgjatja e procedurës së zhvilluar në lidhje me lëndën [C.nr.77/20] në Gjykatën Themelore prej më shumë se 11 (njëmbëdhjetë) vitesh, është e paarsyeshme, për shkak se: (i) çështja e parashtruesit të kërkesës nuk rezulton të jetë e një natyre tejet të ndërlikuar sa që do të mund të justifikonte tejzgjatjen e konstatuar vetëm në shkallë të parë; (ii) parashtruesi i kërkesës ishte relativisht aktiv në zgjidhjen e çështjes së tij; dhe se (iii) gjykata themelore pavarësisht veprimeve procedurale që kishte ndërmarrë në mbajtjen e vetëm një seance gjyqësore dhe veprimeve përkitazi me jokompetencën lëndore, e njëjta ka deklaruar se ende është në proces të vendimmarrjes, duke rezultuar e ngadaltë dhe jo efikase për të zgjidhur çështjen brenda një afati të arsyeshëm.

76. Rrjedhimisht, si përfundim Gjykata konstaton se kohëzgjatja e procedurës për rastin e parashtruesit të kërkesës, për më tepër se njëmbëdhjetë (11) vite si dhe rreth 5 (pesë) vite pasi rasti është kthyer në kompetencë lëndore, pa u mbajtur ndonjë seancë, ka shkelur të drejtën e saj për gjykim brenda një afati kohor të arsyeshëm, të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

77. Gjykata thekson se përfundimi i lartcekur ekskluzivisht ka të bëjë me kohëzgjatjen e procedurave sa i përket shqyrtimit të rastit të parashtruesit të kërkesës dhe në asnjë mënyrë nuk paragjykon rezultatin e meritave të rastit të saj para gjykatave të rregullta.

78. Në këtë kontekst, në rrethana të rastit konkret, Gjykata thekson se, pas këtij aktgjykimi nëpërmjet të cilit konstatohet shkelja e nenit 31 të Kushtetutës, dhe nenit 6 të KEDNJ-së, gjykatat e rregullta duhet të ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshëm për ta përmbyllur lëndën civile [C.nr.77/20] me prioritet, dinamikë të shtuar dhe brenda një afati sa më të shpejtë kohor, konform gjetjeve të këtij Aktgjykimi.

II. Përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës

79. Gjykata, gjithashtu rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon se si rezultat i zvarritjes së procedurës gjyqësore të njejtit i është cenuar edhe e drejta e pronës, e garantuar me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës.

80. Në lidhje me afatin për paraqitjen e kërkesës, në kontekst të pretendimit për shkeljen e të drejtës në pronë, të garantuar më nenin 46 të Kushtetutës, Gjykata i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së në rastet kur parashtruesit pretendojnë se tejzgjatja e procedurës kontestimore në çështje pronësore përbën një pengesë të vazhdueshme për të gëzuar të drejtën në pronë. Në këto raste, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrim se nuk është e nevojshme të shqyrtohet ky pretendim sipas nenit 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së (shih rastin e GJEDNJ-së *Zanghì kundër Italisë*, nr. 11491/85, Aktgjykim i 19 shkurtit 1991, paragrafi 23) ose se çështja e tillë është e parakohshme (shih rastin e GJEDNJ-së *Beller kundër Polonisë*, nr. 51837/99, Aktgjykim i 1 shkurtit 2005, paragrafi 74).

81. Duke iu kthyer rrethanave të rastit konkret, Gjykata duhet ta shqyrtojë pranueshmërinë e pretendimit për shkeljen e nenit 46 të Kushtetutës në kontekst të kriterit të pranueshmërisë së shterimit të mjeteve juridike, të përcaktuar në nenin 49 të Kushtetutës. Në këtë drejtim, Gjykata rithekson praktikën e saj gjyqësore, e cila në parim njeh tri kategori të rasteve kur kërkesa e paraqitur mund të shpallet e papranueshme për shqyrtim për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike të përcaktuara me ligj, e ku njëra nga këto raste është kategoria e "*kërkesës së parakohshme*" (shih ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI09/19, me parashtrues *Leutrim Hajdari*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 shkurtit 2020, paragrafët 40-43; KI179/20, me parashtrues *Telekom i Kosovës Sh. A.*, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 janarit 2021, paragrafi 95; dhe KI49/22, me parashtrues *Zejnel Ninaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 30 gushtit 2023, paragrafi 59; dhe rastet e GJEDNJ-së *Bilsena Šahman kundër Bosnje dhe Hercegovinës*, nr. 40110/16, Vendim i 25 prillit 2017 dhe *Alenka Šaver kundër Sllovenisë,* nr. 18105/13, Vendim i 7 shkurtit 2017).

82. Andaj, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe vetë Gjykatës në lidhje me kategorinë e kërkesave të parakohshme, duke qenë se kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës për anulim të vendimeve të Kuvendit Komunal përkitazi me procedurën e shpronësimit të pronës kontestuese, është duke u gjykuar ende pranë Gjykatës Themelore, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesit të kërkesës përkitazi me pretendimin për shkeljen e së drejtës në pronë, cilësohet si kërkesë e kategorisë të "*kërkesës së parakohshme*" dhe rrjedhimisht, kërkesa refuzohet në pajtim me nenin 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit dhe pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 34 (Kriteret e pranueshmerisë) të Rregullores së punës (shih rastin e Gjykatës, *mutatis mutandis*, KI33/25, parashtruese *Dobrila Rakić,* Aktvendim për papranueshmëri, i 4 shtatorit 2025, paragrafët 86-89).

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, në nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 48 (1) (a) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur më 23 prill 2026, njëzëri:

VENDOS

I. TË SHPALLË kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të paragrafit 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkitazi me të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm kohor;

III. TË URDHËROJË Gjykatën Themelore në Prizren që jo më larg se 23 tetor 2026, ta informojë Gjykatën Kushtetuese lidhur me masat e ndërmarra për zbatimin e këtij aktgjykimi, në pajtim me paragrafin 5 të rregullit 60 (Zbatimi i vendimeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese;

IV. T'UA KUMTOJË këtë aktgjykim palëve dhe, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës;

V. TË KONSTATOJË që ky aktgjykim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtarja raportuese **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Remzije Istrefi-Peci Nexhmi Rexhepi